

FJALA E DEPUTETIT DAMIAN GJIKNURI

E ENJTE 31 MARS 2022

E nderuar drejtuese e seances,

Të nderuar kolegë,

Qytetarë që na dëgjoni,

Në fakt, teksa dëgjoj të gjithë tërsëllëmin opozitar, më kujtohet shprehja që nganjëherë jo çdo krizë apo e keqe të vjen për keq. Këtë krizë që erdhi këtu, e cila është e keqe për popullatën shqiptare, dikush e krahasoi me cunam, mua më pëlqeu shumë fjalimi i një opozitari parafolës, zotit Dule konkretisht, i cili preku të gjitha vendet dhe Shqipërinë. Kur thashë se jo çdo e keqe vjen për keq, më kujtohen bashibozukët opozitarë, të shpartalluar pas një krize politike, të cilët të vetmin konsensus që gjejnë për të sulmuar qeverinë e kanë në këtë foltore.

Pas një krize të thellë të tyren politike ata gjetën një casus belli, nga një krizë që dikush tha cunam dhe më pëlqen si shprehje, sepse cunami ka efekte të jashtëzakonshme, dikush tjetër do të thoshte termet, por atë do të ma atribuonit mua, e cila u dha këtyre një oportunitet që të fillojnë me radhë dhe të sulmojnë qeverinë. Pse është kjo dëshirë e madhe për të sulmuar qeverinë, kur e dimë që kriza është kaq e madhe, efekti është kaq i rëndë, çmimet nuk kontrollohen nga qeveria shqiptare dhe zinxhiri ndërkombëtar i furnizimit është ndërprerë?! Të gjitha këto janë të vërteta dhe të gjithë lexojmë dhe shikojmë. Këtu dalin togfjalësja të rinj nga fjalori opozitar. Këta dy togfjalësja kanë: “Hiqni taksat” dhe “Qeveria grup i strukturuar kriminal”. Kush është qëllimi? Njerëzit kanë dëshpërim, unë e kuptoj! Ka njerëz që preken ekonomikisht. Por të thuash duhen hequr taksat, këtë e preka si temë edhe javën e kaluar, do të thotë ta lësh qeverinë të zbuluar për skenarë, që ne nuk i dimë se si do të zhvillohen.

Parimi i heqjes së taksave nuk është që të përfitojnë të gjithë, puna është që të përfitojë më i varfëri. Të gjitha këshillat, pra prudenca e ekonomisë apo e atyre, që janë responsible për aspektin e fiskut, është e tillë: targeto njerëzit në nevojë, targeto më të varfrit dhe qeveria këtë po bën me politikën sociale; po mbron shtresat më në nevojë. A duhet më shumë? Mbase duhet më shumë; patjetër! Kush tha se nuk ka ndjeshmëri qeveria? Cila është ajo qeveri që nuk do të donte të kishte ndjeshmëri? Problemi është se sa janë mundësitë! Thashë se kjo krizë sapo ka filluar. Lexova pak më parë parashikimet ndërkombëtare, që thoshin se kriza e sivjetme e ushqimeve mund të vazhdojë deri në 2 vjet. Çfarë do të bëjë qeveria?! Do të ngrejë duart? Do të rishikojë disa projekte dhe po i rishikon; edhe rishikimi i buxhetit ka ndërprerë investimet; ka ndërprerë shërbime, që mund të quheshin jo aq të domosdoshme për momentin, por funksioni i shtetit nuk mund të bjerë, sepse ju këtë doni.

Prandaj, kur thoni “qeveria grup i strukturuar kriminal”, e di ku e keni ju?! Doni që njerëzit ta shikojnë qeverinë si diçka kriminale. Ky është ai paradoksi i krizës politike që keni brenda jush. Pse? Në momentin që nuk ke organizatë politike, nuk ke shpresa, nuk ke mbështetës, dështon me protesta, dështon me votë; e vetmja shpresë është tërmeti politik, cunami, të bjerë qeveria. Pra, synoni të “shkërmoqni”

qeverinë në sytë e publikut. Pse?! Duke e parë si njësi kriminale apo duke i nxitur njerëzit me idenë se kjo qeveri duhet përmbysur, sepse e mira do të vijë nga përmbysja. Kjo është e vetmja shpresë që ka i dëshpëruari. Kjo është asimetria te ju, paradoksi te ju, kërkoni të vini në pushtet me “tokën e djegur”. E përmenda javën e kaluar: kufoma. Pra, “ideja e kufomave, toka e djegur, të krijohet një mundësi e artë, të ndodhë diçka e madhe dhe, mbase, do të vij edhe unë”. Andej nga Vlora thoshin njëherë, se më iku edhe Bujari: “Një herë i sjell lumi kucrat”.

Pra, edhe ju: erdhi kjo krizë e madhe, hajdeni të përfitojmë nga rasti. Jo, por qytetarët shqiptarë i lexuan. Dikur kishte protestues, që ishin të ndjeshëm për efektet e çmimeve, përpara se të dilnin masat e qeverisë. Qeveria reagoi dhe protestat u zvogëluan. Ju vajtët t’i hidhni “karburant”, i nxitët dhe disa ju përzunë, sepse jo të gjithë janë për protesta politike, sepse shikojnë alternativën, madje edhe ai që, mbase, nuk është shumë i kënaqur me qeverinë shqiptare, e cila mund t’i kishte bërë disa gjëra më mirë. Madje edhe unë mund të kem argumentet e mia, sepse çdo njeri ka eksperiencat e tij, por, kur ju shikojnë ju, thonë: “Mos o Zot, më mirë të rrijë Edi Rama, sepse kjo qeverisje i ka dhënë provat”. Ju nuk keni kohezion për gjënë më të thjeshtë brenda vetes suaj. Ju nuk mbani dot gjallë organizatën tuaj, jo më pastaj të merrni përsipër të drejtoni një shtet. Fatkeqësi është, sepse unë do të doja të kishte ekuilibër jeta politike, por kjo është e vërteta.

Prandaj i vetmi shans që keni ju, është të merrni mikrofonin dhe të flisni me radhë, se sa ia doni të mirën këtij populli dhe se sa keq po punon qeveria. Bëhuni të arsyeshëm! Unë e di që arsyeja, ndoshta është fjalë e madhe, është luks në Shqipëri, sepse, kur inati është i madh, arsyeja nuk ka vlerë fare. Ama, një qeveri e përgjegjshme, nuk mund të zbatojë çdolloj kërkese që vjen nga oreksi juaj, se mendoni se po u bëni mirë njerëzve. Heqja e të gjitha taksave, siç propozoni ju, do të thotë ta lësh arkën e shtetit bosh. E dyta, nëse kriza zgjat dhe arka e shtetit është bosh, atëherë shteti do t’i ngrejë duart dhe do të plotësohet skenari juaj. Jo, këtë nuk e bëjmë ne. E treta, ku e dimë ne se si do të performojë ekonomia? Nga jeni të sigurt ju? Sepse e dëgjoj këtë, keni gjetur një korrelacion dhe thoni: “Janë rritur çmimet; do të rriten taksat dhe do të ketë më shumë të ardhura qeveria!” Po, qeveria do të ketë edhe më shumë shpenzime, ekonomia mund të kontraktohet.

Ju e dini shumë mirë që ka disa fabrika sot në Shqipëri që, për shkak të destabilitetit të çmimeve të lëndëve të para, të çmimit të energjisë, mund ta kenë ndërprerë prodhimin. Kjo ndikon në ekonomi dhe do të thotë më pak të ardhura. Natyrisht, do të reflektohet edhe në taksat. Nga e nxorët ju korrelacionin? Ju e shikoni ekonominë: po u rriten çmimet, nuk afektohet asgjë. Po, është rritur edhe shërbimi i borxhit. Ju e shikoni që po rriten interesat ndërkombëtare të parasë që Shqipëria ka marrë borxh. Patjetër, Shqipëria ka marrë borxh, si çdo vend që ka borxhe, sepse çdo qeveri ka marrë borxhe. Borxhi, kur është në funksion të zhvillimit, është i domosdoshëm. Nuk është ndonjë gjë e keqe borxhi kur administrohet siç duhet, por edhe shërbimi i borxhit do të kërkojë para ekstra. Nga do të dalin këto? Për energjinë unë sot e dëgjova, dhe e dija 500 milionë, me llogaritë e mia si ish-ministër, sepse bëj skenarët e mi. Ka skenarë edhe më të këqij, 600 milionë euro është e gjitha barrë që e merr buxheti i shtetit për energjinë. Nga do të dalin këto para? Nga buxheti i shtetit. Nëse ecim me skenarin që të eliminojmë çdolloj taksë, nesër ose nuk do të kemi furnizim me energji, ose do të detyrohemi t’i liberalizojmë çmimet, siç e kërkon ligji.

Ligji kërkon liberalizim e çmimeve. Shqipëria këto angazhime i ka marrë që në kohën tuaj dhe i ka vazhduar edhe në kohën tonë. Sot të gjitha bizneset e lidhura në tensionin 20 kilovat, do të ishin me çmim të liberalizuar. Kjo do të thotë do të kishin një çmim mbi 30 lekë. E kanë 18 lekë; është rritur pak, por përsëri koston kryesore e ka mbajtur qeveria. Ky është një risk dhe një e mirë publike. Është kundër rregullave të tregut, por është politikë sociale për dobishmëri publike për të mbajtur prodhimin gjallë. Rritja e çmimeve, çrregullimi i zinxhirit të furnizimeve, mund të sjellë ngecje të shumë linjave të prodhimit; mund të sjellë ndalim të kantierëve, gjë që do të ndikojë direkt në ekonomi. E duam ne këtë?! Ju këtë doni. Ju doni që çdo gjë të shkërmoqet dhe të jetë keq. Ju nuk fitoni dot me votë, ndaj e vetmja mundësi për është rënia e qeverisë së Edi Ramës. Ata njerëz që dinë, ose duan të qeverisin, nuk e duan këtë, por duan ta marrin me votë, duan ta marrin shtetin të shëndoshë, duan ta marrin vendin me rregulla, sepse do të përballen vetë me situatat. Jo, juve ju ka rënë ajo shpresë, prandaj kërkonin sjellje të papërgjegjshme nga qeveria, por qeveria po bën atë që ka mundësi. Ka filluar të adresojë shtresat më në nevojë. Ky proces sapo ka filluar. U sigurua edhe nga Kryeministri, u tha edhe nga ministrja e linjës që sapo filluar dhe ne do të shikojmë rast pas rasti se si do të operojmë për t'i mbështetur shtresat më në nevojë, por të bësh thirrje të tilla dhe ta quash grup i struktura kriminal qeverinë!

Ju doni që çdo vendimmarrje të këtij shteti ta nxirrni kriminale. Po qeveritë nuk krijohen për qëllime kriminale. Edhe po ka shkelje dhe ka përgjegjësi të një, dy apo tre individëve, nuk mund ta nxjerrësh shtetin si një organizatë kriminale, sepse atë shtet nesër po e konkurren vetë me zgjedhje që ta drejtosh. Ajo është një organizatë e krijuar me ligj për qëllime publike, por ju ashtu doni ta përcillni në sytë e njerëzve, sepse doni thjesht të mbillni urrejtje për një gjë që, normalisht, luftoni nesër ta merrni përmes zgjedhjeve. Shpresa iu ka rënë. Prandaj, falë Zotit, për ju erdhi kjo krizë që të keni mundësi t'i unifikoni sulmet tuaja ndaj qeverisë. Sa për sulme ndaj njëri-tjetrit, jua kam thënë që jeni te fillimi i procesit të shkërmoqjes totale. Më vjen keq, sepse prapë nuk do t'ju përmbushet profecia që qeveria do të bjerë dhe ju do të vini një ditë në pushtet. Faleminderit!